



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

UDHËZUES PËR GAZETARË

Ekstremizmi i dhunshëm: defnimi dhe terminologjia





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

UDHËZUES PËR GAZETARË

Ekstremizmi i dhunshëm:
definimi dhe terminologjia

Autor:
Skender Perteshi

Asistent i hulumtimit:
Shpat Balaj

Koncepti dhe redaktimi:
Garentina Kraja

Maj 2018

© Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta 2011/04-L-065. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.



Ky projekt është financuar nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit dhe Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	6
Hyrje	7
Sfondi i ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë.....	9
Aspekti Ligjor	14
Terminologjia që ndërlidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin e shprehur në propagandën e grupeve terroriste	16
Praktika të mediave ndërkombëtare për raportimin mbi aktivitetet e “Shtetit Islamik”	28

LISTA E SHKURTESAVE

QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
LHT	Luftetar i Huaj Terrorist
ISIS	Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut
ISIL	Shteti Islami i Irakut dhe Levantit
PK	Policia e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
IOM	Organizata Ndërkombetare për Migrim
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
AP	Associated Press (televizion amerikan)
CNN	Cable News Network (televizion amerikan)
BBC	British Broadcasting Corporation (Korporata Britanike e Transmetimit)
DKT	Drejtori kundër terrorizmit

HYRJJE

Ky udhëzues është një përpjekje e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) që në bashkëpunim me mediat e Kosovës të adresojë mungesën e një përmbledhje të terminologjisë dhe praktikave që kanë lindur si nevojë e një studimi dhe raportimi më të saktë dhe përmbajtësor të lidhur me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Në këtë udhëzues, QKSS-ja, me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Ambasadës amerikane në Kosovë, përmes një konsultimi të gjerë me redaksitë e lajmeve të mediave, redaktorët dhe gazetarët e korrespondentët lokalë nëpër komunat e Kosovës dhe në kryeqytet sjellë një dokument si produkt të hulumtimit dhe përvojave të gjata të hulumtuesve të saj për ta njohur dhe studiuar ekstremizmin e dhunshëm dhe prejardhjen e tij në Kosovë.

Ekstremizmi i dhunshëm është fenomen relativisht i ri në Kosovë dhe në fillet e tij studiuësit dhe gazetarët sikur në botë ashtu edhe në Kosovë shpesh nuk i kanë poseduar njohuritë teorike dhe praktike për të raportuar mbi këtë dukuri, në vecanti për një rrymë dhe sfidë të sigurisë që ishte pothuaj tërësisht e panjohur për ta. Ndonëse në një situatë dukshëm të përmirësuar, mediat në Kosovë, për dallim nga mediat botërore që kanë investuar në procedura standarde dhe themelimin e zyrave ligjore dhe etike, vazhdojnë të mos kenë një platformë të përbashkët për të standardizuar raportimin mbi ekstremizmin e dhunshëm. Përmes këtij dokumenti QKSS-ja synon të nisë një bashkëpunim që është treguar frytdhënës në Kosovë mes mediave, studiuësve dhe shoqërisë civile për të shtyer përpara një agjendë progresive që në qendër të përpjekjeve ka demokratizimin e sferës publike dhe nxitjen e një debati të mirëfilltë për ta informuar sa më saktë qytetarin e Kosovës.

Ndonëse u drejtohet mediave si adresë primare, udhëzuesu është një përpjekje fillestare për ta harmonizuar njohurinë për ekstremizmin e dhunshëm dhe për të sqaruar një mori çështjesh që kanë të bëjnë me këtë dukuri. Ai u dedikohet për përdorim edhe institucioneve të Kosovës, organizatave joqeveritare, instituteve studimore, analistëve dhe komentatorëve dhe të gjithë studiuesve që kërkojnë njohuri bazike për ekstremizmin e dhunshëm.

Në vijim, ky udhëzues paraqet një përmbledhje të sfondit dhe fakteve kryesore tashmë të etabluara për ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë, një përmbledhje të aspektit ligjor të trajtimit të këtij fenomeni, disa praktikave të mediave ndërkombëtare rreth raportimit për grupet e caktuara terroriste dhe sulmet terroriste, dhe një fjalorthi prej mbi 7 000 fjalësh që janë pjesë e propagandës së organizatës terroriste "Shteti Islamik" e që nuk kanë pasur përdorim të mëhershëm në Kosovë me qëllim që të rrisin vetëdijen e mediave për përdorimin e këtyre fjalëve apo termeve në raportimet e tyre.

SFONDI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË

- > Prej vitit 2012 deri më tani, rreth 403 qytetarë të Kosovës kanë udhëtuar në vatrat e luftës në Siri dhe Irak. Prej tyre rreth 255 janë luftëtarë të huaj, kurse të tjerët janë gra dhe fëmijë;
- > Një numër i madh i luftëtarëve të huaj terrorist të Kosovës kanë udhëtuar me familje në Siri dhe Irak. Mbi 80% e udhëtimeve me familje nga Kosova për në Siri dhe Irak kanë ndodhur pas shpalljes së “Kalifatit Islamik”. Ende nuk ka ndonjë shpjegim apo studim serioz se cilat janë arsyt kryesore pse një numër i madh i familjeve nga Kosova kanë udhëtuar në Siri dhe Irak si pjesë e ISIS dhe organizatave tjera;
- > Në shtator të vitit 2014, nën udhëheqjen e SHBA-ve u themelua Koalicioni Ndërkombëtar kundër Terrorizmit për mposhtjen e Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS). Kosova është anëtare e këtij koalicionit dhe ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën kundër tërërorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitetet e Kosovës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë vlerësuar shumë nga partnerët nderkombetarë të përfshirë në këtë koalicion;
- > Deri më tani raportohet se rreth 75 qytetarë të Kosovës e kanë humbur jetën në luftën e Sirisë dhe Irakut. Poashtu, raportohet për një grua dhe një fëmijë nga Kosova që kanë gjetur vdekjen në Siri dhe Irak, por jo si shkak i luftimeve, por për arsye ende të panjohura. Asnjë nga rastet e të vrarëve dhe vdekjeve të qytetarëve të Kosovës në luftërat e Sirisë dhe Irakut nuk janë të konfirmuara zyrtarisht;

- > Kosova shquhet për përgjigjen e ashpër kundër individëve që kanë qenë pjesë e organizatave terroriste në Siri dhe Irak. Në korrik të vitit 2014, Policia e Kosovës në një operacion në gjithë vendin, ka arrestuar rreth 80 individë, të cilët dyshohet se kanë financuar, mbështetur organizatën terroriste “Shteti Islamik” dhe kanë rekrutuar qytetarë të Kosovës e i janë bashkangjitur organizatave terroriste si ISIS, Al Fateh al SHAM dhe tjera, të cilat ishin aktive në Siri dhe Irak;
- > Shumica e luftëtarëve të huaj terrorist nga Kosova (LHT në gjuhën shqipe, FTF në gjuhën angleze) kanë udhëtuar në vatrat e luftës në Siri dhe Irak gjatë vitit 2012 deri në pjesën e parë të vitit 2014. Shkuarja e tyre në këto vise i parapriu shpalljes së të ashtuquajturit “Shteti Islamik” në Siri dhe Irak;
- > Nga Siria dhe Irakut janë kthyer rreth 130 qytetarë. Prej të kthyerve 117 janë luftëtarë të huaj, kurse të tjerët janë gra dhe fëmijë.
- > Besohet që në vatrat e Sirisë dhe Irakut gjenden afersisht 140-150 qytetarë të Kosovës, shumica e të cilëve janë gra dhe fëmijë. Një numër i vogël i tyre gjenden në Turqi. Deri më tani kthimi i tyre në Kosovë ka qenë i pamundur për shkak të refuzimit të Turqisë për pranimin e tyre dhe organizimin e kthimit të tyre në Kosovë. Institucionet e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë dhe kanë bërë përgaditjet e nevojshme për pranimin dhe riintegrimin e qytetarëve të saj në Kosovë, sidomos të grave dhe fëmijëve;
- > Pjesa më e madhe e të kthyerve janë burra të cilët pas kthimit janë ndjekur penalisht dhe arrestuar për këtë vepër penale, ndërsa vetëm shtatë gra dhe pesë fëmijë janë regjistruar si të kthyer në këtë periudhë. Kthimi i luftëtarëve të huaj përbënë shqetësim të sigurisë për shkak të përvojës së tyre me aktivitete terroriste në fushën e betejës, shkathtësive të tyre luftarake, trajnimit në përdorimin e armëve, lidhjeve me rrjetet terroriste ndërkombëtare, si dhe potencialin e tyre për të radikalizuar të tjerët nëse kthehen në komunitetet të pa mbikëqyruar;

- > Kosovari i parë i vrarë në Siri si luftëtar i huaj është Naman Demolli, në dhjetor të vitit 2012. Vrasja e tij ishte sinjali dhe dëshmia e parë se qytetarët e Kosovës po marrin pjesë aktivisht në luftimet në Siri dhe Irak përkrah organizatave të ndryshme terroriste aktive në Siri e më vonë edhe në Irak;
- > Ndër luftëtarët terroristet më të njohur nga Kosova i cili është vrarë nga forcat amerikane në Siri është Lavdrim Muhaxheri nga Kacaniku. Ai ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve rekrutuese të "Shtetit Islamik" në Kosovë dhe propagues i narracionit të kësaj organizate terroriste në Kosovë dhe hapësirat shqipfolëse. Ai shpesh ka postuar foto dhe video duke vrarë civilë sirian dhe irakian, si dhe duke postuar video propaganduese për "Shtetit Islamik" të Sirisë dhe Irakut;
- > Në nëntor të vitit 2015, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Kosovës ua revokoi lejet e punës 16 organizata joqeveritare të cilat ishin aktive në Kosovë me dyshimet se po punonin kundër rendit juridik të Kosovës. Këto organizata që operuan kryesisht nën petkun e organizatave humanitare fetare janë mbyllur dhe kanë pushuar aktivitetet e tyre në Kosovë;
- > Një numër i konsiderueshëm i fëmijeve të cilët e kanë të paktën një prind nga Kosova kanë lindur në Siri. Identifikimi dhe integrimi i tyre në Kosovë në momentin që kthehen do të jetë sfidë për institucionet shtetërore, të cilat nuk kanë ende strategji se si t'i qasen këtij problemi.

Nën mbikqëqyrjen dhe udhëheqjen e Policisë së Kosovës (PK), respektivisht Drejtorisë Kundër Terrorizmit, (DKT dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) në nëntor të vitit 2016 janë arrestuar 19 qytetarë të Kosovës dhe 4 të Shqipërisë si të dyshuar për tentim sulm ndaj ekipit kombëtar të Izraelit në futboll. Sipas raporteve të ndryshme, ky sulm ishte urdhëruar nga Lavdrim Muhaxheri (ISIS) dhe synimi ishte të sulmoheshin lojtarët dhe tifozët e kombëtarës izraelite të futbollit si dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës dhe AKI në bashkëpunim me institucione partnere me sukses e kanë parandaluar këtë tentim sulmi. Ky tentim sulmi ngjalli shqetësim të veçantë sepse shumica e të akuzuarve nuk ishin luftëtarë të huaj terrorist dhe aktivizimi i një celule të tillë në Kosovë për të kryer sulme terroriste nxiti dyshime për fillet e mundshme të terrorizmit me rrënjë vendore.

Viti 2015 e sidomos viti 2016 ka shënuar rënie të trendit të udhëtimit të qytetarëve të Kosovës për të qenë pjesë e organizatave terroriste në Siri dhe Irak. Vlerësohet se kjo ka ndodhur për shumë arsye, duke filluar nga veprimet e organeve të rendit të Kosovës për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, miratimit të ligjit që ua ndalon qytetarëve të Kosovës të marrin pjesë në konflikte të huaja jashtë territorit të Kosovës, arrestimeve të shumta nga Policia e Kosovës, rritjes më të madhe të kontrollit kufitar, sulmeve ajrore ndaj ISIS nga ana e koalicionit ndërkombëtar, humbjes së territorit nga ana e ISIS, si dhe ndryshimit të strategjisë së organizatës terroriste, e cila nuk rekruton më luftëtarë të huaj, por urdhëron dhe inkurajon sulme terroriste në shtete ku jetojnë simpatizuesit e saj;

Në vitin 2017 dhe 2018 nuk është raportuar për ndonjë i qytetarëve të Kosovës që kanë udhëtuar për në Siri, Irak apo vende tjera, si pjesë e organizatave terroriste;

Përveç luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet arrestimeve dhe proceseve gjyqësore, Kosova ka filluar edhe me zbatimin e programeve të riintegritit dhe deradikalizmit për të burgosurit të cilët kanë qenë pjesë e luftës së Sirisë dhe Irakut. Momentalisht është duke u zbatuar programi për rehabilitimin e luftetarëve të huaj terrorist të cilët gjenden në burgjet e Kosovës. Ky program zbatohet në koordinim dhe mbështetje të ICITAP-it amerikan, misioni në Kosovë;

Autoritetet kosovare nuk kanë strategji dhe nuk kanë marrë veprime konkrete për riintegrimin apo rehabilitimin e grave dhe fëmijëve të rikthyer dhe familjarëve të LHT-ve dhe ish LHT-ve të cilët janë prekur nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi. Përveç disa pakove të shpërndara në fundvitin e kaluar nga Ministria e Punëve të Brendshme më mbështetje të IOM, misioni në Kosovë, asnjë vizitë tjetër apo program për riintegrimin apo rehabilitimin e tyre nuk është ndërmarrë në komunitetet ku ata jetojnë. Sipas hulumtimit të QKSS në komunitetet e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm, ofrimi i ndihmës dhe përkujdesjes për mirëqenien e familjarëve të ish LHT-vë dhe LHT-ve të kthyer duhet të jetë kompetencë dhe në mandat të autoriteteve lokale në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e jo nga Ministria e Punëve të Brendshme si është bërë deri më tani;

Aktualisht, aktivitetet në Kosovë (të ndërmarrë nga qeveria, donatorët ndërkombetarë apo OJQ-të) kanë mbetur në nivelin e takimeve, konferencave, punëtorive dhe debateve. Në esencë, këto aktivitete zhvillohen mes akterëve të angazhuar në këtë fushë dhe nuk po arrijnë që të prekin komunitetet e rrezikuara nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi siç janë familjarët e ish LHT-ve dhe LHT-ve që ende gjenden në vatrat e luftës, si dhe komunitetet tjera duke përfshirë komunitetet etnike pakicë në Kosovë.

ASPEKTI LIGJOR

Kosova ka hartuar dhe miratuar dokumente të cilat kanë për qëllim adresimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në Kosovë. Politikat shtetërore të sigurisë dhe legjisllacioni përcjellës i kanë definuar hapat dhe aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren për ta luftuar dhe parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Ato janë pikë reference për mediat dhe shoqërinë civile të cilat i monitorojnë, studiojnë dhe raportojnë mbi veprimet e institucioneve të Kosovës karshi kësaj dukurie dhe sfidave që lindin gjatë përballjes me ekstremizëm të dhunshëm.

[Më poshtë janë të përshkruara shkurtimisht dokumentet kryesore të cilat trajtojnë terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.](#)

Kodi Penal - Çështjet e lidhura me terrorizmin, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm kryesisht trajtohen në kuadër të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kodi Penal është tejet i detajuar kur është fjala për sanksionimin e veprave që lidhen me terrorizmin, përfshirë këtu rekrutimin, financimin, ndihmën dhe promovimin e urrejtjes fetare dhe etnike.

Ligji për “Ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit”

Në vitin 2015 Kosova miratoi Ligjin **Nr. 05 / L-002** për “Ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit” për qytetarët e Republikës së Kosovës. Miratimi i këtij ligji është hap i rëndësishëm në përpjekjet për të parandaluar qytetarët e Kosoëvs që t’iu bashkangjiten grupeve ekstremiste dhe luftave të huaja. Ligji synon të plotësojë hendekun në Kodin ekzistues Penal i cili nuk e sanksiononte shkuarjen dhe bashkangjitetjen e qytetarëve të Kosovës në një konflikt të huaj si veprë penale. Mungesa e një dispozite të tillë ligjore ishte problematike sepse siç thonë qartë parimet e Kodit Penal, asnjë qytetar nuk mund të dënohet përveç nëse ekziston një dispozitë e qartë që i nejtji ka kryer një veprim të caktuar të paligjshëm. Ndërkohë, ky ligj mundësoi eliminimin e

dilemës për natyrën e kësaj vepre duke e penalizuar bashkimin e qytetarëve të Kosovës në konflikte të armatosura jashtë vendit deri me 15 vite burg.¹

Ligji për “Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”

Kuvendi i Kosoës në vitin 2010 miratoi ligjin **NR 03/L-196** për “Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit,” një tjetër aspekt ligjor i cili adreson [është] që lidhen me terrorizmin. Ky ligj kaloi nëpër proces të rishqyrtimit në vitin 2016, kur u shfuqizua dhe u zëvendësua me ligjin **NR. 05/L-096**, i cili ka të njëjtin fushëveprim, por që është plotësuar me dispozita të reja. Ky ligj trajton procedurat e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe përmes tij synohet luftimi i financimit të terrorizmit.²

Qeveria e Kosovës në vitin 2015 miratoi “Strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm 2015-2020”

(në tekstin e mëtutjeshëm: Strategjia), një dokument i ri që përcakton qëllimet dhe qartëson aktivitetet ndërinstitucionale që duhet të ndërmerren për t’iu përgjigjur nevojave dhe sfidave të reja të sigurisë në vend. Strategjia shërben si bazë dhe planifikim strategjik për zbatimin e një shumëllojshmërie të aktiviteteve në fusha të ndryshme ekonomike, sociale, politike dhe arsimore.³⁴

Ndër të tjera, në harmoni me **“Strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm,”** Kosova ka miratuar edhe Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit dhe Planin e Veprimit. Në këtë strategji parashihen hapa konkret në shërbim të parandalimit dhe luftimit të terrorizmit në Republikën e Kosovës.

1 Perteshi, S., Qehaja, F. dhe Vrajolli, M. (2017). *Mapping the state of play of institutional and community involvement in countering violent extremism in Kosovo*. [online] Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS_Needs_Assesment_final_42754.pdf

2 Për më shumë shih: Law No. 03/L-196 on the Prevention of Money Laundering and Terrorism Financing, Assembly of Kosovo, 30th September 2010

3 ibid

4 Për më shumë shih: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

TERMINOLOGJIA QË NDËRLIDHEN ME EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN E SHPREHUR NË PROPAGANDËN E GRUPEVE TERRORISTE

Xhihad - Sic është e përshkruar në Kur'an dhe burime tjera fetare fjala "Xhihad" mund të ketë shumë kuptime. Me xhihad mund t'i referohemi përpjekjeve të besimtarëve musliman për të qenë besimtarë të devotshëm dhe informimin e personave tjerë rreth besimit islam. Fjala "xhihad" gjithashtu ka kuptimin e mbrojtjes së Islamit. Njëri nga interpretimet përcakton se nëse për mbrojtjen e besimit islam nuk funksionojnë metodat paqësore, atëherë lejohet edhe përdorimi i dhunës por me rregulla strikte të paracaktuara. Dhuna ndaj të pafajshmëve, grave, fëmijëve dhe invalidëve është rreptësisht e ndaluar në ekzekutimin e "Xhihadit Usharak" dhe çdo përpjekje paqësore e armikut duhet të pranohet. Megjithatë, aspekti ushtarak i xhihadit është vetëm njëri nga kuptimet e tij dhe nuk mund të kufizohet vetëm në këtë aspekt. Fja-

la arabe që i referohet luftës është "Al-Harb" prandaj interpretimi i fjalës "Xhihad" si "Luftë e Shenjtë" është e gabuar edhe në aspektin linguistik.

Xhihadi sipas ISIS - Organizatat terroriste siç janë Al-Kaida dhe ISIS vazhdimisht kanë keqpërdorur fjalën "Xhihad." Ata e kanë interpretuar atë vetëm në kuptimin e ngushtë të luftës ofanzive dhe përdorimit të dhunës nga ana e muslimanëve ndaj jo-besimtarëve dhe të tjerëve që nuk ndajnë të njëjtën ideologji me ato grupe. Grupet terroriste përmes "Xhihadit" kanë tentuar ta legjitimojnë vrasjen e civilëve të cilët nuk i nënshtrohen urdhërave të grupeve terroriste. Grupet e tilla kanë bërë përpjekje që aktet e tyre të fshehin nën petkun e "Xhihadit" si luftë për Allahun më tendencë për të arsyetuar luftën dhe dhunën që ata përdorin. Përvetësimi i këtij koncepti të luftës së shenjtë

për të arsyetuar terrorin e ushtruar nga organizatat terroriste është pjesë qendrore e propagandës së këtyre grupeve.

Xhihadist - Me termin “Xhihadist” në literaturën fetare quhen ata individë që angazhohen fuqishëm në ndjekjen dhe përhapjen e besimit islam në mënyrë paqësore, pa i shkaktuar dëme tjetrit dhe që vazhdimisht bëjnë përpjekje për t’u bërë besimtar sa më të devotshëm.

Xhihadist sipas ISIS - Njëjtë si te fjala “Xhihad”, organizatat terroriste termin “Xhihadist” e kanë kufizuar vetëm në aspektin e luftës ofanzive, përdorimit dhe arsytimi të dhunës dhe terrorit. Sipas këtyre organizatave “Xhihadist” është çdo individ i cili lufton jo-besimtarët, vendet perëndimore dhe shtetet sekulare si dhe përfaqon ideologjitë e organizatave terroriste. Pjesëtarët e organizatave terroriste e quajnë veten “xhihadist,” një emërtim tërësisht joadekuat.

Rekomandim - Rekomandohet që fjala “Xhihad” dhe “Xhihadist” të ketë përdorim minimal, apo të mos përdoret fare, kur raportohet për organizatat terroriste dhe pjesëtarët e tyre.

Me përdorimin e fjalës “Xhihad” gjatë raportimit për organizatat terroriste pa dashje mediat e legjitimojnë kauzën e tyre. Nëse përdoret, kjo fjalë të paktën duhet të kontekstualizohet dhe krahas saj të përmenden masakrat, vrasjet, spastrimet etnike dhe krimet e tjera të kryera nga organizatat terroriste në emër të fesë apo “Xhihadit”. Poashtu, kur i referohet kauzës së organizatave terroriste, kjo fjalë sugjerohet të futet në thonjëza ose t’i referohemi si “i ashtuquajturit Xhihad sipas organizatës terorriste” dhe përveç lajmit në fjalë të vendoset edhe një informacion/argument shtesë për konceptin e “Xhihadit” dhe keqinterpretimin e përvetësimit e këtij koncepti nga terroristët për të legjitimuar dhunën e tyre.

Viteve të fundit mediat më prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare u janë referuar pjesëtarëve të organizatave terroriste si “Xhihadist”. Duke iu referuar atyre si “Xhihadist” iu bëhet një nder dhe në mënyrë indirekte i shërbehet kauzës së tyre terroriste. Rekomandohet që fjala “Xhihadist” të përdoret sa më pak nga mediat dhe gjatë raportimit për pjesëtarët e grupeve ekstreme të quhen terrorist, anëtar i organizatës terroriste apo luftëtar terrorist.

Kalifati - Kalifati është nocioni i një shteti Islamik të udhëhequr nga Kalifi, i cili është udhëheqës politik dhe religjioz i shtetit dhe përfaqëson të gjithë besimtarët e besimit Islam. Kalifati i fundit ka ekzistuar në kohën e Perandorisë Osmane.⁵

Kalifati sipas ISIS - ISIS ka arritur që përmes propagandës së tij të bindë individ dhe grupe nga e gjithë bota se ata kanë krijuar kalifatin utopik të njohur si “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut”. Sipas ISIS-it “Shteti i ri” është vendi ku mund të jetojnë të lirë të gjithë muslimanët, të pakufizuar në ushtrimin e fesë së tyre, dhe ka inkurajuar të gjithë t’i bashkohen këtij koncepti dhe ta njohin liderin e tij si “Kalif” de fakto të të gjithë muslimanëve.

Si të përdoret – Rekomandohet që kur raportohet mbi “Shtetin Islamik” të futet në thonjëza apo t’i referohet si “i ashtuquajturit Shteti Islamik” dhe në çdo rast të kontekstualizohet që fjala është për një qëllim të një organizate terroriste dhe jo ndërtimin e një shteti të vërtetë.

Hadith - Afërsisht 200 vite pas vdekjes së profetit Muhamed porositë dhe veprat e tij janë përcjellur gojarisht nga gjenerata në gjeneratë. Në shekullin e nëntë ka filluar mbledhja dhe regjistrimi i fjalëve, veprave apo porosive së profetit të cilat tashmë njihen si Hadithe.

Kafir - fjalë arabe që përdoret për mosmirënjohes ose jo-besimtar. Islami si një besim monoteist, dhe Kurani urdhërojnë besimin në një Zot të vetëm dhe premtan dënim për ata të cilët refuzojnë Perëndinë (Allahun si sundimtarin e vetëm të botërave) dhe nuk janë besimtarë lojal. Në Kosovë, një version i kësaj fjale, “qafir,” është përdorur në gjuhën popullore për t’i përshkruar njerëzit e ligë dhe nuk është lidhur shumë me të qenit apo jo praktikues strikt i religjionit, e cila ka ndryshuar viteve të fundit.

Përdorimi sipas ISIS - ISIS dhe grupet tjera terroriste e kanë përdorur fjalën “kafir” për të gjithë ata të cilët nuk e kanë përqaftuar ideologjinë e tyre terroriste. ISIS dhe grupet e tjera terroriste “kafir” i kanë quajtur të gjithë muslimanët tjerë të cilët nuk kanë qenë antarë të tyre dhe nuk kanë ndjekur agjendën e njejtë me këto grupe.

5 Qendra për Studime për Lindjen e Mesme” 2012 <https://cmes.uchicago.edu/sites/cmes.uchicago.edu/files/uploads/Glossary%20of%20Terms.pdf>

Daesh (Da'ish) – Fjala Daesh ka gjetur përdorim të gjerë në Lindjen e Mesme dhe jo vetëm për të ju referuar grupit terrorist “ISIS.” Fjala Daesh kryesisht përdoret për të sfiduar legjitimitetin e grupit për shkak të konotacionit negativ të fjalës. Daesh në parim është akronim i shkronjave të para të emrit të vjetër të grupit, “al-Daëla al-Islamiya fil Iraq ëa al-Sham”. Edhe pse si fjalë nuk ka kuptim në gjuhën arabe, ajo tingëllon e pakëndshme dhe përkrahësit e grupit terrorist ISIS kanë refuzuar ta përdorin atë.

Sheriati - Sheriati është baza juridike islamee dhe konsiderohet si sistem rregullues i jetës dhe organizimit fetar e shtetëror islamik. Sheriati përfshinë udhëzime ligjore gjithëpërfshirëse për të gjitha fushat e jetës të cilat janë të justifikueshme dhe të pranueshme në islam.⁶ Parimet themelore të shariatit janë përcaktues i modelit që një individ i besimit Islam duhet të ndjek për devotshmëri ndaj Zotit: Lutjet, humanizmi, agjërimi dhe pelegrinazhi. Në thelb, Sheriati është tërësia e urdhërave të Zotit siç janë të përcaktuara në librin

e shenjtë të Kuranit dhe dokumentet tjera juridike.⁷

Muxhahid – Përshkrim për muslimanët të cilët marrin pjesë në mbrojtjen e territoreve islamike, ose bëjnë përpjekje të ndryshme për t'i mbrojtur të shtypurit, të varfërit ose të shfrytëzuarit apo i rezistojnë shtypjes së shtetit apo pushuesve të huaj. Me muxhahid ju referohet atyre që vdesin duke i qëndruar besnik të vertëtës dhe luftës së shenjtë.

Lufta e Shenjtë - Lufta e Shenjtë është koncept që përmbledhë përpjekjet për mbrojtjen e fesë islame. Lufta e shenjtë për dallim nga Xhihadi, është e kufizuar në kuptimin klasik të luftës. Megjithatë, lufta e shenjtë i ka rregullat e veta strikte se kur duhet të ndodhë dhe ajo mund të fillojë vetëm me shpalljen nga autoriteti legjitim fetar. Në fenë islam “Lufta e Shenjtë” mund të bëhet për vetëmbrojtje, kur një shtet sulmon një shtet islamik apo nëse një shtet, sekular apo jo, i sulmon qytetarët e vet muslimanë. “Lufta e Shenjtë” sipas fesë islame duhet të zhvillohet në mënyrë të kujdesshme, pa e dëmtuar popul-

6 Ibid:

7 Christine Schirrmacher The Sharia – Laë and Order in Islam https://www.iirf.eu/site/assets/files/92914/ëea_gis_10_-_christine_schirrmacher_-_sharia.pdf

latën civile, të bëhet përdorimi minimal i forcës pa inate dhe zemërim dhe të burgosurit të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe të dinjitetshme.

Organizatave terroriste si ISIS ndër të tjerash i kanë shtrembëruar edhe parimet e “Luftës së Shenjtë”. Ata i kanë prezantuar vetëm elementet që ju përshtaten grupeve përkatëse dhe agjendave të tyre. “Lufta e Shenjtë” e proklamuar nga ISIS nuk përmbanë asnjë element të “Luftës së Shenjtë” të argumentuar përmes Kuranit dhe dokumenteve tjera religjioze. ISIS ka kryer krime të rënda ndaj civilëve, ka keqtrajtuar robërit e luftës dhe ka shpallur luftën e shenjtë pa qenë autoritet legjitim fetar. Për më shumë, lufta e tyre si e tillë nuk është mbështetur nga bota muslimane.

Shteti Islamik – Shtet Islamik konsiderohet çdo sistem shtetëror i cili qeveriset në bazë të rregullave fetare islame dhe si bazë kryesore të funksionimit të shtetit e ka ligjin e Sheriatit. Grupi terrorist **Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut (ISIS)** – është organizatë terroriste që doli në skenë në vitin 2014 pas marrjes nën kontroll të një pjese të madhe të Sirisë dhe Irakut. Ky emërtim është manipulues me qëllim që të joshë përkrahjen e besimtarëve mus-

limanë për gjoja potencialin e krijimit të një shteti të tillë të udhëhequr nga parimet fetare. I ashtuquajtur “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut” nuk mund të konsiderohet si shtet Islamik për arsye të cilat mund të gjinden në pjesët tjera të këtij teksti. Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut ka pasur emërtime të ndryshme në mediat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, duke filluar nga Shteti Islamik (IS), Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut (ISIS), Shteti Islamik i Sirisë dhe Levantit (ISIL) apo DAESH. Agjencia botërore e lajmeve Associated Press i është referuar këtij grupi si “Grupi i Shtetit Islamik” në raportimet e tyre për të qenë sa më e qartë që fjala është për organizatë dhe jo shtet dhe për të mos krijuar pa dashje lidhjen e këtij grupi me fenë islam si tërësi.

Sunni - Është sekti më i madh në fenë islam, i cili përbënë 85% të muslimanëve në gjithë botën. Sunitët kryesisht janë të shtrirë në vendet si: Egjipti, Siria, Arabia Saudite, Turqia, Afganistani, Afrika e Veriut, Jordania, Palestina dhe shumica e popullatës Islame në vendet e Ballkanit, përfshirë vendet shqipfolëse. Shumica e grupeve terroriste në botë si

ISIS dhe Al-Kaida kanë pretenduar se i përkasin sektit Sunni.⁸

Shia - është sekt i dytë më i madh në fenë islam pas sektit Sunit. Qendra e shtrirjes së sektit shiit në botë është Irani. Numër i madh i popullatës Shia gjindet edhe në Irak, Liban dhe Bahrejn.⁹ Përçarjet mes sektit Sunnit dhe Shiit datojnë që nga kohët e hershme të islamit dhe lidhen me trashëgimtarët e profetit Muhamed, të cilët kishin pikëpamje të ndryshme se kush duhet të jetë trashëgimtar dhe çfarë rruge duhet ta ndjekin muslimanët në botë.¹⁰

Kryeimam - Është autoriteti më i lartë fetar në interpretimin e ligjit kuranor dhe rregullimin fetar në një vend me ku ka komunitet të besim fetar islam. Ky titull zakonisht përdoret nga sektit sunit. Në rastin e Kosovës ky titull ndërlihet me Myftiun e Kosovës, udhëheqësin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK).¹¹

Imam – Emërtim për kryesuesin e lutjeve në xhami apo udhëheqësit fetarë të vendit ose komunitetit të caktuar.

Kuran - është baza kryesore e fesë islame dhe njihet si Libri i Shenjtë. Sipas besimtarëve muslimanë, Kurani është fjala e Zotit dhe ajo çfarë thuhet në të është e domosdoshme të zbatohet dhe respektohet nga çdo musliman në botë.

Sahab/Sahabët – është emërtim për miqtë apo bashkëudhëtarët e profetit Muhamed. Dijetarët e ndryshëm islamikë kanë shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me përkufizimin e “sahabit (shoqëruesit)”. Sipas dijetari të njohur islam me origjinë tuniziane Hafiz Ibn Haxher al-Asqalani në librin e tij të quajtur “el-Isaba” i përkufizon “Sahabët” si “person që besoj në Pejgamberin, erdhi së bashku me Profetin dhe vdiq si musliman”.¹²

Selefizmi - është një doktrinë islame që buron nga një hadith (thëniet dhe veprimet e profetit Muhamed) që thotë: “njerëzit më të mirë janë ata që jetojnë në brezin tim, dhe pastaj ata që do të ndjekin ata, dhe pastaj ata të cilët do të ndjekin këta të fundit”. Kjo është një thirrje për muslimanët që të ndjekin shembullin e atyre tre gjeneratave të

8 Associated Press, Stylebook 2006. P 128.

9 Ibid;

10 Ibid;

11 Ibid;

12 Hafiz Ibn Haxher al-Asqalani në librin e tij “el-Isaba”

para duke filluar me profetin, si referencat më të besueshme në interpretimin e fesë islame¹³. Në përgjithësi, salafistët janë më pak të prirur drejt angazhimit politik aktiv duke preferuar në vend të kësaj një qasje “të qetë” të predikimit fundamentalist të islamit, edukimit fetar dhe shmangies së konfrontimit me autoritetet shtetërore. Një pakicë e selefistëve mund të quhen edhe si selefi-xihadistë, apo të dhunshëm, prej të cilëve mund të jenë motivuar një gurp i organizatave terroriste.¹⁴ Kjo ideologji fetare i ka rrënjët dhe është zhvilluar si e tillë nga Arabia Saudite.

Mënyra e përdorimit - Shpeshherë mediat dhe studiues të ndryshëm organizatave terroriste u janë referuar si “selefistë terroristë,” shprehje e cila është e gabuar për shkak se me anë të atij emërtimi legjitimohen ato organizata dhe preket një komunitet më i gjerë i besimit islam të cilët jo domosdoshëmrish lidhen me terrorizmin. Në këto raste gjatë përdorimit të

fjalës selefi preferohet të përcillet me fjalët i/e dhunshëm ose i/e padhunshëm.

UMMA/Umeti Islam - Është fjalë arabe me të cilën i referohet “komunitetit”, “grupit” apo “kombit”. Kjo fjalë merr konotacion religjioz në Kuran, ku thuhet se Zoti i ka dërguar secilit “Ummah” profetin e tij, Moisiun për hebrejtë, Jezusin për të krishterët dhe Muhamedin për muslimanët. Në parim Ummah mund të përshkruhet si koncepti modern i shtetësisë, por megjithatë në besimin Islam “shtetësia” fitohet në bazë të përkushtimit dhe mobilizimit në baza fetare, pavarësisht etnisë. “Umma” përfaqëson një rend botëror universal, të udhëhequr nga një qeveri islamike në bazë të ligjit të Sheriatit.¹⁵

Ekstremizmi - Në ditët e sotme me ekstremizëm i referohemi kryesisht ideologjive politike dhe religjioze të cilat kundërshtojnë konsensusin shoqëror. Megjithatë, fjala ekstremizëm nuk mund të kufizohet vetëm në ideologji të ndryshme, pasi që ajo përdoret edhe për të treguar diçka përtej normales ose një kundërshtim të fortë për diçka të caktuar. Me termin ekstrem nuk

13 http://www.qkss.org/repository/docs/Shkaqet_dhe_pasojat_e_perfshirjes_se_qytetareve_te_Kosoves_si_luftetare_te_huaj_ne_Siri_dhe_Irak_820753.pdf

14 Islam Salafizm and Jihadism; 2016 <https://www.brookings.edu/blog/markaz/2016/07/15/islamism-salafism-and-jihadism-a-primer/>

15 Ibid;

mund t'i referohemi vetëm një komuniteti apo ideologjie të caktuara, pasi ekstremja ka forma të ndryshme të manifestimit varësisht nga komuniteti/ideologjia.¹⁶

Ekstremizmi i dhunshëm – Lloji i ekstremizmit që synon përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve politike. Ky koncept përfshinë, por nuk kufizohet, vetëm në terrorizëm. Për shembull, ekstremistët e dhunshëm që sulmojnë pjesëtarët e policisë ose të ushtrisë, ose që marrin pjesë në luftime, zakonisht nuk konsiderohen terroristë.¹⁷

Terrorizmi - Përdorimi i dhunës dhe shkaktimi i frikës ndaj popullsisë civile për arritjen e qëllimeve politike të një organizate terroriste. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.

Nusja e xhihadistit apo xhihadistja

- U referohet grave që mundohen të shtrijnë fenë islame, bëjnë përpjekje që të bëhen besimtare të devotshme dhe angazhohen për zbatimin e rregullave

fetare,, si dhe të përhapin religjionin në mënyrë paqësore duke mos i shkaktuar dëmë tjetrit.

Nusja e xhihadistit apo xhihadistja sipas ISIS

është term i ri përdorur shumë së fundmi si pasojë e një numri të madh të grave të cilat kanë udhëtuar me burrat e tyre, apo të vetme për të jetuar dhe martuar me luftëtarët e organizatave terroriste si ISIS (DAESH) the AL NUSRA FRONT. Edhe ky është një koncept i shtrembëruar nga organizata terroriste për ta legjitimuar veten si përfaqësues të denjë të besimit islam.

Namazi - Namazi është njëri nga 5 shtyllat kryesore të cilat çdo besimtar i fesë islame e ka për obligim t'iu përmbahet. Namazi sipas Islamit është formë e marrëdhënies spirituale mes njerëzve dhe Zotit, praktika e lutjes dhe e falenderimit ndaj Zotit.

Hoxhallarët e Hakut - Përkrahësit e grupeve ekstremiste, përkatësisht ISIS-it, në rrjete sociale janë aktiv në citimin dhe promovimin e imamëve nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria të cilët janë të dënuar për vepra terroriste si rekrutimi apo nxitja e gjuhës së urrejtjes. Këta hoxhallarë sipas tyre quhen "Hoxhallarët e Hakut," që nënk-

16 Strategjia per Parandalimin e Ekstremizmit te dhunshëm 2017. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

17 Ibid:

upton gjoja hoxhallarët e vërtetë. Ata janë imamët më kundërthënës të vendit, të cilët kanë qëndrime refuzuese ndaj proceseve demokratike dhe e minojnë rendin shtetëror. Këta imamë shquhen për gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit shia, besimit të krishterë dhe hebrenjëve. Zakonisht të ashtuquajturit “Hoxhallarët e Hakut” predikojnë një linjë tjetër të religjionit nga ajo që zyrtarisht praktikohet nga bashkësia fetare dhe shumica prej tyre kundërshtojnë publikisht bashkësitë islame në vendet përkatëse.¹⁸

Hoxhallarët e Shtetit - është togfjalëshi i përdorur nga simpatizantët e ISIS-it në Ballkan për t’i përshkruar imamët që janë pjesë e bashkësive islame në vendet shqipfolëse të cilët praktikojnë islamin duke u bazuar në rregullat e përcaktuara nga institucionet fetare në vendet e tyre përkatëse. Këta imamë janë të kontraktuar nga bashkësitë fetare si institucione zyrtare islame. Organizatat terroriste dhe përkrahësit e tyre nuk i njohin këta

imamë si legjitim për shkak se nuk i kanë përkrahur ideologjitë e tyre të dhunshme dhe kanë kundërshtuar fuqishëm rekrutimin e shqiptarëve për tu bërë pjesë e organizatave terroriste. Grupet terroriste dhe përkrahësit e tyre këta imamë i konsiderojnë si tradhtarë për shkak se bashkëjetojnë në harmoni me shtetin sekular.

“Islami në rrezik” - ISIS dhe grupet tjera terroriste e kanë përdorur këtë argument për të rekrutuar luftëtarë të huaj. Sipas tyre “islami është në rrezik” nga “kryqtarët dhe jo-besimtarët” (Amerika dhe Perëndimi). Sipas tyre, Lindja e Mesme dhe besimi islam janë në rrezik për shkatërrim nga “imperialistët e Perëndimit, Amerika dhe kryqtarët” dhe se muslimanët e gjithë botës duhet të luftojnë dhe ta mposhtin këtë rrezik. Poashtu, grupet terroriste si ISIS me këtë mesazh ju drejtohen edhe qeverive sekulare që qeverisin në vendet me shumicë muslimane. Sipas tyre, edhe këto autoritete duhen luftuar.¹⁹

18 KCSS “NEW BATTLEFIELDS EXTREMIST GROUPS’ ACTIVITY ON SOCIAL NETWORKS IN KOSOVO, ALBANIA AND FYROM” 2017 http://www.qkss.org/repository/docs/New_Batelgrounds_Extremist_Groups_in_Social_Media_738865.pdf

19 Brookings Institute “The Ideology of Islamic State” 2016 : <https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/The-ideology-of-the-Islamic-State.pdf>

Shejtan - Fjala “shejtan” në thelb do të thotë “i papastër” dhe “i ulët/i pa vlerë.” Shejtan i referohet një entiteti të rebeluar, pavëresisht a është në formën e njeriut, kafshës apo xhindëve. Shejtan sipas fesë islame mund të konsiderohet “një shpirt i neveritshëm që është distancuar nga Allahu dhe e vërteta.”²⁰

Dabiq - Dabiq është qytet në Sirinë Veriore. Sipas fesë Islame, Dabiq do të jetë vendi në të cilën do të zhvillohet beteja përfundimtare mes forcave islamike dhe armiqëve të tyre “kryqtarë” që në këtë rast ISIS i interpreton si forcat e krishtera dhe/ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Profecia e Dabiqit është e ngjajshme me gojëdhënat e Krishterizmit për një betejë përfundimtare mes forcave krishtere dhe atyre “Anti-Krisht” para fitores së madhe të Perëndisë.²¹

Xhehnet - Parajsa në besimin islam. Xhehneti rrjedhë nga një fjalë arabe që ka kuptimin “të mbulosh ose të fshehësh diçka.” Sipas Kuranit, Xhehneti është “Jeta e përjetshme e paqes dhe

lumturisë pas vdekjes, ku besimtarët dhe të drejtët do të shpërblehen.”²² Ky koncept fetare është përdorur nga ISIS dhe organizatat terroriste për të joshur luftëtarë si gjoja shpërbim për sakrificën aktuale.

Al Qaida - Al Qaida rrjedhë nga fjala arabe e cila do të thotë “Baza” apo “Themeli”. Al Qaida është organizatë terroriste që ka për synim të deklaruar eliminimin e pranisë ndërkombëtare në vendet arabe të cilët kundërshtuan ushtarakisht politikat e jashtme perëndimore. Al Qaida u themelua nga Osama bin Laden në vitin 1988.²³

Taghut - Fjala taghut rrjedh nga fjala “Tugyan” e cila do të thotë “Të tejkalosh kufijtë/limitet”. Taghut sipas fesë islame është “kushdo që tejkalon limitet duke i veshur vetës të drejta që i takojnë vetëm Allahut dhe e bën vetën partner me Allahun.” Me taghut poashtu nënkuptohet çdo adhurim ndaj dikujt/dicka tjetër përveç Allahut, akt i ndaluar sipas fesë islame.²⁴ Shtetet sekulare dhe ato

20 Për më shumë shih: <https://www.al-islam.org/180-questions-about-islam-vol-2-various-issues-makarim-shirazi/7-what-meant-shaytan-noble-quran>

21 Për më shumë shih artikullin e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-30083303>

22 Për më shumë shih: <https://www.thoughtco.com/definition-of-jannah-2004340>

23 Për më shumë shih: <https://www.counterextremism.com/threat/al-qaeda>

24 Për më shumë shih: <http://from.the.depths.of.darkness.into.light.over-blog.com/article-71795909.html>

të cilat nuk funksionojnë në bazë të parimeve fetare islame konsiderohen si “taghut” nga organizatat terroriste. Organizatat terroriste u kanë bërë thirrje të gjithë muslimanëve që të përdorin të gjitha mjetet për ta luftuar shtetin e “taghutit,” dhe të zbatojnë parime fetare islamike në funksionimin dhe qeverisjen e shtetit.

Komunitetet e qëndrueshme - nënkupton angazhimin aktiv të komunitetit dhe aktorëve të ndryshëm të pajisur me njohuritë dhe mekanizmat bazik për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Ky koncept poash-tu përfshinë qëndrimin e komunitetit ndaj një fenomeni të tillë dhe reagimin e tyre në rast të shfaqjes së aktivitetit të dhunshëm ose ngjarjeve që shpiten në aktivitete të tilla.

Shami – Shami është fjala arabe për që i referohet rajonit të Sirisë (Siria e sotme, Libani, Jordania, Izraeli, Palestina dhe pjesë të Turqisë jugore) pas pushtimit të kësaj zone nga arabët. Kjo hapësirë gjeografike deri në shekullin e 7-të i takoi Perandorisë Bizantine.

Kryqali - Propaganda e organizatës terroriste “Shteti Islamik”(ISIS) dhe përkrahësve të tyre vazhdimisht i referohet botës perëndimore si “Kryqalitë.” Kryqalitë sipas tyre janë ata të cilët gjatë gjithë historisë kanë pasur synim zhdukjen e fesë islame dhe vazhdojnë të ushtrojnë represion ndaj muslimanëve nëpër botë. Narracioni i “kryqalive” realisht nuk ka ndonjë bazë të qëndrueshme historike, megjithatë përbënë një element të fortë propagandues pasi me përdorimin e këtij termi në konotacion negativ synohet mobilizimi i masës për “kundërpërgjigje ndaj shtypjes” së muslimanëve në botë.

Munafik – emërtim arab me të cilin besimtarët musliman u referohen mohuesve të fesë së tyre dhe Zotit dhe për t’i përshkruar ata si hipokritë dhe të rrezikshëm për fenë Islame.

Takfir – deklaratë teologjike që i referohet dikujt që mohon fenë e tij, një personi jo besimtar apo një akti apo ideje që përbënë mosbesim në islam. Të qenit tekfir është çështje tejet serioze në islam pasi konsiderohet mëkati më

ii madh që do të bartë pasoja në këtë jetë dhe atë të pas vdekjes.²⁵

Sulmet vetvrasëse - janë ndër metodat e shpeshta që ISIS dhe grupet tjera terroriste i kanë përdorur për të sulmuar vendet dhe qytetarët në Lindje të Mesme, vendet perëndimore dhe vende tjera. Kjo ka qenë një taktikë shumë e njohur dhe e përdorur nga ISIS së fundmi pas humbjeve të mëdha që i ka pësuar në ofanzivën e forcave shtetërore të sigurisë në Irak dhe Siri, si dhe sulmeve të koalicionit të udhëhequra nga SHBA ndaj ISIS dhe grupeve tjera terroriste aktive në Siri dhe Irak. Para se të përdoren nga grupet terroriste në Lindje të Mesme sulme vetëvrasëse janë ndërmarrë nga pilotët kamikaz japonez gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kanë qenë taktikë e ushtruar nga kryengritësit tamil në Shri Lankë.

Shteti Sekular – Kur një shtet është neutral sa i përket religjionit, nuk kundërshton apo përkrahë ndonjë religjion, praktikat apo aktivitetet e tyre, por në të njëjtën kohë ua garanton dhe siguron të drejtat për praktikimin e besimit qytetarëve pa asnjë dallim. Një shtet sekular i trajton qytetarët e tij në mënyrë të barabartë, pavarësisht besimit apo mos-besimit në një religjion të caktuar.

25 Për më shumë shih: <http://www.css.ethz.ch/en/services/digital-library/articles/article.html/316b8048-d26a-44cb-b4ce-48d8167f1c7c/pdf>

PRAKTIKA TË MEDIAVE NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIMIN MBI AKTIVITETET E “SHTETIT ISLAMIK”

Në mungesë të një standardi të aplikueshëm nga mediat ndërkombëtare për raportim të aktiviteteve të organizatave terroriste dhe veprimeve të tyre, në këtë udhëzues QKSS-ja ka përmbledhur disa praktika të mediave me shtrirje ndërkombëtare që do të mund të huazohen dhe aplikohen nga mediat në Kosovë. Një adaptim i këtyre praktikave rrethanave të raportimit në Kosovë do t’iu jep përgjigje disa çështjeve etike me të cilat përballen mediat në vend dhe do t’iu ndihmojë në heqjen e dilemave për etikën profesionale. QKSS-ja është plotësisht e vetëdijshme që këto vendime merren në mënyrë të pavarur nga dhomat e lajmeve dhe redaksitë e mediave në Kosovë, prandaj kjo është vetëm një përpjekje për të sjellur në këtë udhëzues përvojat se si mediat ndërkombëtare i kanë zgjidhur disa nga dilemat për të raportuar mbi këtë fenomen. Vlenë të theksohet që procesi i raportimit për aktivitetet e organizatave terroriste, në veçanti të veprimeve të ISIS ka evoluar me kohë, sikur që ka avancuar njohuria për grupet terroriste dhe ideologjitë e strategjitë e tyre të komunikimit. Gjykimi për raportimin e këtyre ngjarjeve bëhet në bazë të vlerësimit të secilit rast veç e veç, prandaj secila përpjekje për të gjeneralizuar apo për të krijuar një standard të vetëm është problematike. Megjithatë, në raportimin për veprimtarinë e ISIS tashmë janë vendosur disa pika koncenzusi.

Emri ISIS – Politika editoriale e shtëpisë mediatike BBC është që “Shteti Islamik” të kualifikohet si “Grupi Shteti Islamik” apo “iashtuquajturi Shteti Islamik” apo “organizata që e quan veten Shteti Islamik.” Pjesëtarët e organizatës përshkruhen si “luftëtarë, militantë apo ekstremistë të ISIS-it.” Emërtimi “Islamist” përdoret si mbiemër për të

përshkruar ekstremizmin që lidhet me grupet e tilla, por jo “islamik” e as “islam.”²⁶ Ngjajshëm kanë vepruar edhe mediat tjera me shtrirje globale “me qëllim që mos ta krijojnë përshtypjen që është fjala për një shtet funksional por që bëhet fjalë për një grup të vetëm militant që kontrollon një copë të ndryshueshme territori.”²⁷

Transmetimi i videove propagandistike të ISIS – Videot brutale të ekzekutimit të pengjeve perëndimore kanë qenë pjesë qenësore e propagandës së organizatës “Shteti Islamik” dhe janë përdorur si mjet për të ngjallur pasiguri dhe frikë, por edhe për të nxitur simpatizuesit e tyre. Mediat ndërkombëtare ju kanë qasur në mënyra të ndryshme këtyre videove. Për shembull, fillimisht televizioni amerikan CNN ka transmetuar fotografi të gazetarit amerikan të ekzekutuar nga ISIS, ndërkohë që ka përshkruar përmbajtjen e videos që organizata terroriste ua kishte shpërndarë mediave ndërkombëtare. Më vonë, me rasti e ekzekutimit të një punëtori humanitar amerikan, CNN e ka përshkruar videon, por nuk ka transmetuar fare pamje të ekzekutimit, por fotografi të punëtorit humanitar derisa po bënte punë vullnetare në Siri.²⁸ CNN “filloi të transmetojë më pak e më pak pamje apo xhirime... sepse u bë e qartë që ISIS-i dëshironte që ne t’i publikojmë ato pamje.”²⁹ Ngjajshëm kishte vepruar edhe televizioni Al-Jazeera që ka shtrirje të gjerë në botën arabe dhe Lindjen e Mesme. Ky medium kishte vendosur të mos publikojë asnjë pamje nga videot e ekzekutimit për të mos “shpërblyer ekstremizmin.”³⁰ “Video ishte e punuar për media, jo për qëllimet e tyre” dhe prandaj Al-Jazeera kishte vendosur të mos e transmetojë asnjë pjesë të saj. Ndërkohë, agjencia ndërkombëtare e lajmeve Associated Press, që ka me mijëra

26 Për më shumë, shih BBC Editorial Guidelines <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/>

27 “Why AP Style doesn’t use ISIL or ISIS Anymore,” <https://www.poynter.org/news/why-ap-style-doesnt-use-isil-or-isis-anymore>

28 Zëvendëspresidenti ekzekutiv dhe drejtori menaxhues i CNN, Tony Maddox e ka shpjeguar këtë praktikë në një panel të News Xchange me media tjera perëndimore. Për më shumë, shih “ISIS: Mësimet nga raportimi i CNN, Al-Jazeera dhe France 24,” <https://www.journalism.co.uk/neës/isis-in-the-neës-lessons-for-coverage-from-cnn-al-jazeera-and-france-24/s2/a563156/>

29 ibid

30 Sipas drejtorit të lajmeve të Al-Jazeera Arabic, Ibrahim Helal në panelin e News Xchange. Për më shumë shih <https://www.journalism.co.uk/neës/isis-in-the-neës-lessons-for-coverage-from-cnn-al-jazeera-and-france-24/s2/a563156>

media të parapaguara për shërbimet e saj përreth botës, e gjykon secilin rast sipas standardeve të raportimit të saj, por një parim bazë është që nëse një mesazh ose rrëfim mund të transmetohet në mëyrë efektive përmes një imazhi më pak të përgjakshëm, atëherë përparësi i jepet asaj pamje.

Përdorimi i fjalës “terrorist” – Sipas politikës redaktoriale të BBC-së, “nuk ka konsensus se çfarë përbënë akt terrorist apo kush është terrorist. Përdorimi i kësaj fjale shpesh është çështje gjykimi.” Andaj ky medium ka vendosur një praktikë përmes të cilës e lejojnë karakterizimin apo përdorimin e fjalës terrorist kur ajo përdoret nga bashkëbiseduesit e tyre, mirëpo gazetarët e kësaj medie i shmangen përdorimit të saj. “Kjo nuk nënkupton që të shmangemi nga paraqitja e realitetit apo tmerri i një rasti të veçantë, por duhet të konsiderojmë se si përdorimi i gjuhës tonë do të ndikojë në reputacionin tonë dhe gazetarinë objektive.”³¹

31 Për më shumë shih BBC - Terrorism: Language when Reporting Terrorism në <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/guidance/terrorism-language>

